REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
DREJTORIA E BUJQËSISË, MJEDISIT MENAXHIMIT TOKËS DHE PYJEVE

Nr. 8262/15 **Prot.** **Divjakë, më** 19.10.**2026.**

PROJEKT -- VENDIM
Nr. 94 **Datë** 19.10.**2026.**
"PËR MIRATIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASIN SIMON LILI QORRI PËR BANESËN E DËMTUAR NGA RESHJET E SHIUT"

Mbeshtetur ne ligjin Nr. 139/2015 , date 17.12.2015 ***" Per Veteqeverisjen Vendore "***, i ndryshuar, si dhe ne Ligjin numer 45/2019, "***Per mbrojtjen Civile***", neni 7, neni 30, germa gj, dhe neni 41 në mbështetje të Vendimit numer 329, datë 16.5.2012, "***Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore***", VKM nr.414, date 08.07.2021,***'Per miratimin e procedurave dhe kritereve te ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile***", pika 3.1, germa a, i propozojme Keshillit të Bashkisë Divjakë, në mbledhjen e datës 23.10.2026.

1. Të miratojë akordimin e ndihmës financiare për shtetasin Z. Simon Lili Qorri, banesa e të cilit është dëmtuar plotësisht si pasojë e reshjeve të shiut të datës 08.10.2026, siperfaqja e ndërtimit 39 m^2, në vlerën 50% të vlerës së llogaritur prej 1.796,925lekë. Vlera që perfiton Z. Simon Lili Qorri është 50% e 1,796,925 : 2 = 898,462 lekë.
2. Burimi i financimit është nga fondi i kushtëzuar për vitin 2026, transferuar nga Ministria e Mbrojtjes, programi 'Emergjencat Civile', artikulli 604, kodi i produktit 91707 AB, "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".
3. Për zbatimin e këtij projekt - vendimi ngarkohet: Drejtoria e Bujqesisë, Mjedisit, Menaxhimit Tokës dhe Pyjeve, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria Juridike, Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit të Aseteve.

Specialist Agronom dhe Emergjencave Civile
Ferit Qosja

Përgjegjësi, Drejtoria Juridike
Prokurimeve Publike dhe Menaxhimit te Aseteve
Andi Bullari

Për Drejtorinë e Finances dhe Buxhetit
Xheladin Brahkola

KRYETARI
Josif Gorrea

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA DIVJAKË

Adresa: Sheshi "Santa Barbara",Qender Divjake,Nr.Tel:037122031,email:bashkia.divjake@gmail.com